

URDHËR
Nr. 16, datë 28.1.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE
(Ndryshuar me Urdhrin nr. 19, datë 9.2.2026)

(I përditësuar)

Bazuar në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, në nenet 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin të Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave të kompetencave funksionale si vijon:

a) *Lëshimin e autorizimeve për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Financave në të gjitha proceset gjyqësore dhe procedurat gjyqësore, në të cilat ministria paraqitet si palë në gjykim ose si subjekt i interesuar, si dhe për hartimin, nënshkrimin dhe paraqitjen e kërkesëpadive, dhe të çdo akti tjetër procedural, në përputhje me formatin e autorizimit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe që përbën pjesë përbërëse të tij;*

b) përcaktimin e numrit të punonjësve që shoqërojnë delegacionet e huaja dhe miratimin e programeve për shërbimet e pritje-përcjellje që organizon ministri i Financave;

c) miratimin e kërkesave për kryerjen e orëve shtesë të punës, për punonjësit e strukturës së ministrisë, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) nënshkrimin e kontratave të punës, si dhe aktet për përfundimin e marrëdhënies së punës, për pozicionet që rregullohen me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë;

d) kryerjen e të gjitha veprimeve administrative dhe procedurale në funksion të miradministrit të burimeve njerëzore të sistemit ministror, me përjashtim të atyre që sipas legjislacionit në fuqi u janë ngarkuar organeve kompetente.

2. Delegimin e autorizimit, për dërgim me shërbim jashtë vendit dhe brenda vendit në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës, të nëpunësve dhe funksionarëve të Ministrisë së Financave dhe institucioneve të varësisë sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, zëvendësministër, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Financave dhe institucionet e varësisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

4. Urdhri i ministrit të Financave nr. 3, datë 26.1.2024, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCave
Petrit Malaj

(Shtuar me Urdhrin nr. 19, datë 9.2.2026)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORIA E ANKESAVE ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2026

AUTORIZIM PËR PËRFAQËSIM

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të Urdhrit të Ministrit Financave nr.____, datë _____ “Për delegim kompetence”, në çështjen civile/administrative me palë ndërgjyqëse:

Paditës/Kërkues:

I paditur:

Person i tretë:

Objekti:

VENDOSA:

Autorizimin e Z/Znj. _____, me detyrë _____ dhe Z/Znj _____, me detyrë _____, që së bashku ose veç e veç, të përfaqësojnë Ministrinë e Financave në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes civile/administrative me palë dhe objektin e sipërcituar. Përfaqësuesi ka të drejtën të hartojë, nënshkruajë dhe të dorëzojë kërkesëpadi, kundërpadi, kundërshtim veprimesh përmbarimore, kërkesa të tjera procedurale, prapësime, deklarata mbrojtje, ankim, ankim të veçantë dhe çdo akt tjetër procedural që ka lidhje me gjykimin e kësaj çështje, në përputhje me ligjin dhe në interesin e ligjshëm të Ministrisë së Financave, deri në përfundim të procesit gjyqësor. Në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, përfaqësuesit e autorizuar kanë të drejtë të hartojnë draft-rekursin dhe draft-kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor për paraqitje në Gjykatën e Lartë, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Gentian Këri